



Prishtinë, 10 korrik 2019
Kodi i ZRRE-së: V_1168_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 25 të Rregullës Nr. 11/2017 për Procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja bazuar në Burimet e Ripërtritshme të Energjisë;
- Nenin 18, 19 dhe 20 të Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e BRE-ve,dhe
- Aplikacionin për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në objektin të ndërtuar në parcelën ngastra kadastrave Nr. 00228-2, ZK Prelez, me kapacitet të instaluar prej **69 kW** në Komunën e Ferizajt, të datës 28.05.2019 me nr. prot. 319/2019 të aplikuesit "BESIANA – G" SH.P.K., me adresë: "Marije Shllaku" Nr. 12, Komuna Ferizajt, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur më 10 korrik 2019 nxori këtë:

V E N D I M

PËR NDËRTIMIN E KAPACITETEVE GJENERUESE PËR VETË-KONSUM

- I. APROVOHET**- kërkesa e aplikuesit "BESIANA – G" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, në parcelën ngastra kadastrave Nr. 00228-2, ZK Prelez, me kapacitet të instaluar prej **69 kW** që do të vendosen mbi objekt, në Komunën e Ferizajt.
- II. OBLIGOHET** – aplikuesi "BESIANA – G" SH.P.K., me shifër të regjistruar të njehsorit elektrike DFE-9040820 që pas ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë-konsum, të parashtrij kërkesë në KEDS SH.A., për pranim teknik të objektit energjetik.
- III.** ZRRE do të konsideroj projektin e finalizuar nga data e pranimit teknik sipas Pëlqimit Elektroenergjetik të lëshuar nga KEDS SH.A.
- IV.** Aplikuesi "BESIANA – G" SH.P.K., do të lidh Marrëveshje për vetë-prodhim me furnizuesin me të cilën ka kontratë për furnizim me energji elektrike, pas konfirmimit të pranimit teknik nga KEDS SH.A., në pajtim me nenin 18 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullës Nr. 10/2017 për Skemën Mbështetëse.

Arsyetim




- ZRRE, me datë 28.05.2019 nga aplikuesi "BESIANA – G" SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë – konsum nga panelet solare/fotovoltaike, mbi objektin e ndërtuar në parcelën ngastra Nr. 00228-2, ZK Prelez, me kapacitet të instaluar prej **69 kW**, që do të vendosen mbi objekt, shifra e konsumatorit DFE-9040820, Komuna e Ferizajt.
- Aplikuesi, s'bashku me aplikacioni ka bashkangjitur edhe dëshminë nga KEDS për konsumin vjetorë të energjisë elektrike, vlerësimin për prodhimin vjetor në kW/h të pajisjeve të instaluara, pëlqimin elektroenergjetik Nr. 498 të datës 08.02.2019 të lëshuar nga KEDS SH.A., projektin ekzekutues dhe Vendimin Nr. 04-16/01 të datës 23.05.2019 të lëshuar nga Drejtoria për Planifikimin, Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Ferizajt.
- Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së aplikuesit "BESIANA – G" SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për vetë - konsum nga panelet solare/fotovoltaike në kulmin e objektit të ndërtuar në parcelën ngastra kadastrave Nr. 00228-2, ZK Prelez, me kapacitet të instaluar prej **69 kW**, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se janë plotësuar të gjitha dëshmitë relevante për lëshimin e vendimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për vetë-konsum, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Selman Hoti, anëtar


Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Ferizajt,
- KEDS SH.A.,dhe



- Arkivit të ZRRE-së.

